

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## SikaDecor®-801 Nature

### MIKROÇIMENTO DEKORATIVE DHE ME NGJYRË PËR APLIKIME TË BRENDSHME

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Llaç prej dy përbërësish, me bazë lëndësh lidhëse (binder) hidraulike, aditivë dhe pigmente ngjyre për veshje dekorative në mjedise të brendshme.

#### PËRDORIMET

- Veshje dekorative dhe të njëtrajtshme mbi dysheme dhe mure në mjedise të brendshme
- I përshtatshëm për nënshtresa me bazë çimentoje ose gipsi
- Për dhoma, zyra, papafingo, etj.
- Mund të jetë i përshtatshëm për veshje dekorative në dyqane, shtëpi private, ndërtesa publike me konsumim të lehtë të sipërfaqes

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Dozë paraprake
- Rezistencë e mirë ndaj rrezatimit UV
- Punueshmëri e shkëlqyer
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresë
- Aplikim i shpejtë
- Tepër dekorativ dhe estetik, ofron një sipërfaqe unike
- I transpirueshëm

#### MIRATIME / STANDARDE

Lëndë mbushëse (filler) me 2 përbërës, me bazë lëndësh lidhëse hidraulike, rrëshira sintetike, aditivë dhe pigmente për përdorim dekorativ të mjedise të brendshme sipas EN 1504-2: 2004 dhe EN 13813:2002, DoP 0108030300100000321053, certifikuar nga Organi i Kontrollit të Prodhimit në Fabrikë Nr. 0909 dhe mbart markën CE.

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Mikroçimento e modifikuar me polimere	
<b>Ambalazhi</b>	Përbërësi A:	3.0 kg
	Përbërësi B:	10.0 kg
	Përbërësit A + B:	njësi me dozë 13.0 kg
	Pigmenti SikaDecor®:	500 ml
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Përbërësi A:	Lëng qumështor
	Përbërësi B:	Pluhur i bardhë
	Pigmenti SikaDecor®:	Shikoni katalogun e ngjyrave
<b>Jetëgjatësia</b>	12 muaj nga data e prodhimit në ruhet në ambalazhin original të mbyllur dhe të padëmtuar.	
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Temperaturë magazinimi midis +5 °C dhe +30 °C. Të mbrohet nga ngrirja. Të ruhet në kushte të thata.	
<b>Dendësia</b>	Produkti i freskët:	~ 1.75 kg/l

## TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje > 1.0 N/mm<sup>2</sup> (28 ditë)

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

### Struktura e sistemit

#### Nivelimi

Sistemi i veshjes	Produkti	Konsumimi
Veshja fillestare (0.1-1.0 mm):	Sikafloor®-701 <sup>1)</sup>	~ 1.4 kg/m <sup>2</sup> /mm
Llaçi i vetënivelueshëm (2-3 mm):	Sikafloor®-82 EpoCem®	~ 2.3 kg/m <sup>2</sup> /mm
Vetënivelimi (4-10 mm):	Sikafloor® Level-30	~ 1.8 kg/m <sup>2</sup> /mm

Ju lutemi referohuni tek skeda teknike përkatëse!

#### Sika® EmotionFloor mbi dysHEME

Sistemi i veshjes	Produkti	Konsumimi
Prajmer:	Sikafloor®-701 <sup>1)</sup>	~ 0.4 kg/m <sup>2</sup>
Spërkatje:	Sikadur®-501 N (0.3-0.9 mm)	~ 1.0 kg/m <sup>2</sup>
Shtresa e 1-rë dekoruese:	SikaDecor®-801 Nature	~ 1.5 kg/m <sup>2</sup>
Shtresa e 2-të dekoruese:	SikaDecor®-801 Nature	~ 0.5 - 1.0 kg/m <sup>2</sup>
Izoluesi i 1-rë <sup>2)</sup> :	Sikafloor®-304 W + 20 % ujë	~ 0.1 kg/m <sup>2</sup>
Izoluesi i 2-të:	Sikafloor®-304 W + 5 - 10 % ujë	~ 0.1 kg/m <sup>2</sup>

#### Sika® EmotionFloor mbi MURE

Sistemi i veshjes	Produkti	Konsumimi
Prajmer (sipërfaqe çimentoje):	SikaTop®-10	~ 0.2 - 0.5 kg/m <sup>2</sup>
Prajmer (sipërfaqe gipsi):	SikaTop®-50	~ 0.2 - 0.5 kg/m <sup>2</sup>
Nivelimi <sup>3)</sup> :	SikaDecor®-803 Nature	~ 2.0 kg/m <sup>2</sup> /mm
Shtresa dekoruese:	2 - 3 x SikaDecor®-801 Nature	~ 0.35 - 0.45 kg/m <sup>2</sup> /shtresë
Izoluesi i 1-rë:	Sikafloor®-304 W + 20 % ujë	~ 0.1 kg/m <sup>2</sup>
Izoluesi i 2-të:	Sikafloor®-304 W + 5 - 10 % ujë	~ 0.1 kg/m <sup>2</sup>

<sup>1)</sup> Mundësi tjetër: Sikafloor®-156, Sikafloor®-160 dhe Sikafloor®-161

<sup>2)</sup> Për zona dysHEMEJE që mund të vjetrohen më shpejtë përdorni Sikafloor®-169 si shtresë të 1-rë.

**Kujdes:** Jep ngjyrë më të theksuar (më të errët).

<sup>3)</sup> Mbi gips apo sipërfaqe të lëmuar nuk nevojitet nivelim. Por, konsumimi i shtresës së 1-rë të SikaDecor®-801 Nature shtohet deri në 1.5 kg/m<sup>2</sup>.

Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit të sipërfaqes, profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon etj.

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

### Raporti i përzierjes

Përbërësit A : B =	3 kg : 9 - 10 kg
Shtim pigmenti/ përzierje:	500 ml
Përgjithësi: terracotta, clay, clover:	1000 ml

### Konsumimi

~ 1.75 kg/m<sup>2</sup>/mm

<b>Temperatura e mjedisit</b>	Min. +8 °C, max. +30 °C
<b>Temperatura e nënshtresës</b>	Min. +8 °C, max. +30 °C
<b>Koha e punueshmërisë</b>	~ 30 minuta (+20 °C)
<b>Produkti i aplikuar gati për përdorim</b>	Sistem i izoluar: ~ 4 ditë (+23 °C)

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa nuk duhet të ketë pluhur, materiale të lira, kontaminues të sipërfaqes si vaji, graso, veshje të vjetra me bojë.

Përdorni prajmerin e duhur.

### PËRZIERJA

SikaDecor®-801 Nature përbërhet nga një përbërës pluhur dhe një i lëngët, të cilët duhet të përzihen për të përfunduar konsistencën e dëshiruar.

Për të përfunduar ngjyrën e duhur, pigmenti duhet të shtohet tek përbërësi i lëngët (përbërësi A) dhe duhet të homogjenizohet deri sa të arrihet shpërndarja e saktë.

Për përzierjen, përbërësi i lëngët duhet të hidhet në një kovë të pastër dhe më pas të shtohet ngadalë përbërësi B deri sa të arrihet konsistenca e dëshiruar. Këshillohet përdorimi i një përzierësi elektrik në shpejtësi të ulët (~ 300 rpm).

Këshillohet raporti Përbërësi A : Përbërësi B = 1:3, por mund të modifikohet për të përfunduar një konsistencë tjetër.

Përzieni për të paktën 2 minuta derisa të arrihet një përzierje e njëtrajtshme.

### APLIKIMI

#### Shtresa dekorative

Aplikoni 2 ose 3 shtresa SikaDecor®-801 Nature në varësi të finiturës së dëshiruar dekorative, duke përhapur produktin me një mallë dhe duke shtypur plotësisht produktin mbi sipërfaqe për të përfunduar efektin stuko.

Ndërmjet shtresave të SikaDecor, sipërfaqja duhet të laget paraprakisht deri në ngopje.

Përpara aplikimit të shtresës së dytë, lëreni shtresën e parë të thahet dhe bluani lehtësisht sipërfaqen manualisht me smerilizues të imët (120-18), për të shmangur pabarazitë dhe për të shtuar ndërkapjen. Përsërisni procedurën nëse nevojitet një shtresë e tretë.

Granulometria e smerilizuesit duhet të përzgjidhet nga aplikuesit në varësi të kërkesave. Nevojitet një bluarje përfundimtare përpara aplikimit të përbërësit për izolim.

Rekomandohet një trashësi përfundimtare 1.5 - 2 mm.

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

Për të arritur trashësinë e kërkuar mbi mure, rekomandohet të përdoret SikaDecor®-803 Nature si shtresë e parë për të niveluar sipërfaqen dhe si shtresë e dytë dhe e tretë të përdoret SikaDecor®-801 Nature, për të arritur efektin dekorativ dhe të hijes.

Sigurohuni ajrosje të mjaftueshme në mjediset e brendshme ku do të bëhet aplikimi, në mënyrë që materiali të maturohet dhe të thahet siç nevojitet. SikaDecor®-801 Nature nuk duhet të jetë subjekt i kontaktit të përhershëm me ujë.

SikaDecor®-801 Nature duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi, era dhe shiu të paktën 24 orë pas aplikimit. Në dhoma me lagështi relative të lartë, nevojitet ajrosje e mirë për të shmangur formimin e mykut mbi sipërfaqe.

Nëse nënshtresa ka plasaritje, duhet të riparohen përpara aplikimit të veshjes.

Duhet të respektohen fugat strukturore dhe të lëvizjes. Ngjyrat janë të përafërta dhe mund të ndryshojnë në varësi të kushteve të aplikimit dhe përbërësve për izolim. Ndryshime në njëtrajtshmërinë e ngjyrave mund të ndodhin edhe gjatë ngurtësimit.

Përbërësit për izolim errësojnë gjithnjë ngjyrën dhe mund të ndryshojnë pamjen estetike të produktit bazë.

Në rast të kërkesave estetike, rekomandohet një aplikim provë.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
SikaDecor®-801 Nature  
Mars 2019, Botimi 02.01  
020815030010000025

SikaDecor-801Nature-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf